

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
MATENSE CONSULTING

NENI 1
FORMIMI

Sot me date **12.06.2024** themeluesi qe firmos me poshte:

1. **Sergio GALLELLI**, shtetas italian, lindur me 30.05.1960, ne komunen e Zagarise, (CZ), identifikuar me pasaporten nr YC4598677
2. **Enoglin CANAJ**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 27.03.1974 , identifikuar me pasaporte nr BA15119351

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetarët dhe Shoqerite Tregëtare „ si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombëtare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregëtare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **MATENSE CONSULTING** .

NENI 2
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **MATENSE CONSULTING**, me adrese Tirane, Rruga Pandi Dardha, Pallati 62, shk 3, Ap 26. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **MATENSE CONSULTING** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE


Objekti i veprimtarise se shoqerise **MATENSE CONSULTING** eshte:

-Konsulenca ne fushen e energjise se rinovueshme, duke perfshire por jo te limituar ne fushen e energjise fotovoltaike, eolike, elektike, te cdo kapaciteti instalues dhe gjenerues, ne cdo faze te projekteve.

-Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj.

-Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe I veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qëndrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre reaktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- Investitor ne pasuri te paluajtshme, menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh



-Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtese, me qëllim permbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtëvendit. Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë

- Ofrimi i ndërmjetësimit të furnizimit me pajisje profesionale dhe aksesore ndihmes të tyre, në fushën e ndërtimit, energjisë, .

-Studime, projektme dhe zbatime të inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë elektrike dhe inxhinierisë hidro-mekanike. Projektme konstruktive dhe supervizim punimesh. Studime e projektme dhe zbatime hidrogeologjike dhe gjeologjike.

-Projektme dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik. Studime fizibiliteti. Studime të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Menaxhimi teknik, financiar dhe ligjor i projekteve të ndryshme.

- Shërbimi i dhenies me qera të pajisjeve dhe mjeteve të punës, vecanërisht por pa u kufizuar vetëm në to, si vinci, makineri dhe pajisje të renda në fushën e ndërtimit dhe rikonstruksionit, mjete teknike të imta, vegla profesionale etj.

-Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga ligji vetëm ose në bashkëpunim me palë të treta nëpërmjet nënkontraktimit, qoftë ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promociional, etj që e vlerëson të dobishme në përputhje me ligjin.

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **MATENSE CONSULTING** është **100,000 leke** dhe i ndarë në 2 (DY) kuota me kontributin e ortakëve si më poshtë:

1. Një kuota **Sergio GALLELLI**, shtetas italian, lindur me **30.05.1960**, në komunën e **Zagarisë, (CZ)**, identifikuar me pasaportën nr **YC4598677** në masën **67 %** (gjashtëdhjetëeshtëtë) të kapitalit themeltar.
2. Një kuota **Enoglin CANAJ**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me **27.03.1974**, identifikuar me pasaportë nr **BA15119351**, në masën **33 %** (tridhjetëtre për qind) të kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet në nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISE DHE ASAMBLEJA



Organet drejtuese te shoqërisë **MATENSE CONSULTING** janë:

- Asambleja e Ortakeve, organi me i larte vendimmarres
Administrator te shoqërisë është **Z. Enoglin CANAJ**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 27.03.1974 , identifikuar me pasaporte nr BA15119351.
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, nga data 12/06/2024 deri ne 12/06/2029

NENI 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizik e juridike, vendas apo te huaj, shprehen ne status qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarisë dhe sherbejne per zhvillimin e marrëdhënieve ne kete shoqëri.

NENI 8

Veprimtarine e saj, shoqëria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.

NENI 9

Te gjitha mosmarreveshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirekuptim, me ane te dispozitave te ketij akti, statuti si dhe legjislacioni shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykatë.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar **MATENSE CONSULTING** ne QKB ne kete dite shoqëria **MATENSE CONSULTING** njihet si person juridik.

ORTAKET E SHOQËRIE “ MATENSE CONSULTING” sh.p.k

Sergio GALLELLI

Enoglin CANAJ